



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E BRENDSHME

AGJENCIA SHTETËRORE E PROKURIMEVE TË PËRQËNDRUARA

Nr. ____ Prot.,

Tiranë, më ____ 2024

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM NË
MARRËVESHJEN KUADËR (PARAPRAK)**

12.04.2024

Drejtuar: **“Malvina Visoka”,PF**

Rruga: Tiranë,Linzë Muhamet Veliu, Pallati ILIAD ,Shkalla 1 Kati 1

* * *

Procedura e prokurimit/lotit: **“Procedurë e hapur”** me objekt: **”Blerje Detergjent për Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve”**

Numri i procedurës: **REF-96420-02-26-2024** me objekt: **”Blerje detergjent për Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve”** me fond limit të përgjithshëm: **39,951,333** (tridhjetë e nëntë milion e nëntëqind e pesëdhjetë e një mijë e treqind e tridhjetë e tre) **lekë (pa TVSH)** .

Publikimet e mëparshme: Buletini i Njoftimeve Publike

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: **oferta ekonomike më e favorshme bazuar në çmim X**

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1) **“ATLANTIK 3” SH.P.K**

K22218003V

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Vlera: 0 (Subjekti nuk ka paraqitur ofertë ekonomike).

2) **“MALVINA VISOKA” PF**

L61608005C

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Vlera: 33,750,000 (tridhjetë e tre milion e shtatëqind e pesëdhjetë mijë) lekë pa TVSH (me numra dhe fjalë)

3) **“AN & RA” SH.P.K**

K12205001I

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Vlera: 33,808,000 (tridhjetë e tre milion e tetëqind e tetë mijë) lekë pa TVSH (me numra dhe fjalë)

4) **“EURO MEGA 2010” SH.P.K**

K12205001I

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

-Vlera: 33,650,000 (tridhjetë e tre milion e gjashtëqind e pesëdhjetë mijë) lekë pa TVSH (*me numra dhe fjalë*)

- Vlera: 27,320,000 (njzetë e shtatë million milion e treqind e njëzetë mijë) lekë pa TVSH (*me numra dhe fjalë*)

5) “BESIM KAMBERI” PF

L

42103023 G

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Vlera: 26,945,000 (njzetë e gjashtë milion e nëntëqind e dyzetë e pesëmijë) lekë pa TVSH (*me numra dhe fjalë*)

6) “MURATI-D” SH.P.K

K 42003004

T

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Vlera: 34,761,000 (tridhjetë e katër milion e shtatëqind e gjashtëdhjetë e një mijë) lekë pa TVSH (*me numra dhe fjalë*)

7) “GET KLIN” SH.P.K

L 82420502 U

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Vlera: 0 (Subjekti nuk ka paraqitur ofertë ekonomike).

8) “ANBIM”

L 81618008 J

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Vlera: 21,965,000 (njzetë e një milion e nëntëqind e gjashtëdhjetë e pesë mijë) lekë pa TVSH (*me numra dhe fjalë*)

KVO vendosi të s’kualifikojë / të mos pranojë ofertat e paraqitura nga operatorët ekonomik:

1) “ATLANTIK 3 SH.P.K” 2) “ BESIM KAMBERI” Person Fizik” 3) MURATI-D SH.P.K
4) EURO MEGA 2010 SH.P.K 5) GET KLIN SH.P.K dhe 6)“ANBIM” SH.P.K **për këto arsye:**

1. “ANBIM” sh.p.k

S’kualifikohet

- I.** Operatori ekonomik nuk plotëson pikën 6 të Seksionit 2.3 ”Kapaciteti Teknik” të Kërkesave të Vecanta për Kualifikim, ku është kërkuar: “*Operatori ekonomik per secilen nga produktet do te paraqese flete-analize nga nje organ/institucion i akredituar kombetar/nderkombetar e cila duhet të paraqitet origjinale, ose fotokopje të noterizuara*”. Për këtë pikë subjekti nuk ka paraqitur asnjë nga fletë-analizat e detergjentëve të kërkuara në DST, dhe për rrjedhojë nuk vërteton cilësinë e produkteve detergjent “Pluhur larës për Lavatrice”, “Sapun” dhe “Xhel Enesh”. Vetdeklarimi i ANBIM sh.p.k se do të paraqesë fletë-analizat brenda 60 ditëve pas hapjes të ofertave është i pavlefshëm për efekt kualifikimi pasi në Dokumentat Standarte te Tenderit ,

shtojca 7, është kërkuar që fletë-analizat dhe cdo dokument që shoqëron ofertën të paraqiteshin në ditën e hapjes së ofertave brenda 60 ditë para hapjes së ofertave. Ky fakt është i pakontestueshëm pasi të gjithë operatorët pjesmarrës i kanë paraqitur fletë-analizat ditën e hapjes së ofertave.

- II. Operatori Ekonomik nuk plotëson pikën 5 të Seksionit 2.3 "Kapaciteti Teknik" të Kërkesave të Vecanta për Kualifikim, ku është kërkuar: "*Operatori ekonomik për produktet objekt prokurimi ditën e hapjes së ofertave duhet të paraqes mostrat të cilat duhet të jenë në përputhje me specifikimet teknike në DST, si dhe skeden teknike të prodhuesit në gjuhën shqipe (e përkthyer e noterizuar nëse është në gjuhë huaj*", pasi nuk ka paraqitur skdat teknike të produkteve të ofruara respektivisht" sapun, "xhel enesh" dhe pluhur larës. Për këtë pikë subjekti paraqiti disa vetdeklarime të titulluara "SKEDA TEKNIKE", për detergjent "Pluhur larës për Lavatrice", "Sapun" dhe "Xhel Enesh", ku janë deklaruar të dhëna mbi specifikimet teknike mbi Pamjen, Eren, Emertimet kimike dhe Amballazhimi". KVO konstaton se këto vetdeklarime nuk përbëjnë SKEDA TEKNIKE qoftë nga ana formale qoftë nga përmbajtja e tyre. Vetdeklarimet e paraqitura nuk përmbajnë asnjë nga të dhënat mbi Rreziqet e Produkteve ku përfshihen të dhënat për Paralajmërimet e Rrezikut dhe Rekomandimet e Sigurisë. Këto të dhëna lidhen me rreziqet e kimikatit nese shkakon irritim të syve, nese duhet të mbahet larg pranise së fëmijëve, Rubrika e Masave kundër Zjarrit, Masat për Lirim Aksidental, Funksionimi dhe Ruajtja e Produktit , Kontrolli i Ekspozimit dhe Mbrojtja Personale etj.. KVO arsyeton se mungesa e Skedave Teknike të kërkuara përbën mospërmbushje të një kërkesë thelbësore teknike për kualifikim.

- III. Operatori Ekonomik nuk plotëson pikën 5 të Seksionit 2.3 "Kapaciteti Teknik" të Kërkesave të Vecanta për Kualifikim, në lidhje me origjinalitetin e mostrave të kërkuara. Koncretisht ka paraqitur mostra të parregullta në lidhje me deklarimin e kryer se është prodhues i produkteve për këto arsye:

Mostra "Pluhur larës për Lavatrice", është paraqitur në gjuhën italiane dhe përsipër ambalazhit të produktit mbajnë markën "EPTA" që nuk ka lidhje me deklarimin se produkti është prodhim i ANBIM sh.p.k apo ndonjë marke të regjistruar nga ky i fundit në cilësinë e prodhuesit.

Ambalazhi i paraqitur në lidhje me produktin detergjent "Pluhur larës për Lavatrice", nuk ka të trupëzuar të dhënat mbi produktin në trupin e qeses së ambalazhit por këto të dhëna janë vendosur në një letër me ngjitse . Ky prezantin i mostrës është jashtë çdo standarti prodhimi pasi nuk vërteton origjinalitetin e mostrës dhe përgjegjësitë ligjore të ofertuesit për produktet.

Produkti "sapun" ka një ambalazh të markës EPTA që nuk ka lidhje me deklarimin se produkti është prodhim i ANBIM sh.p.k apo ndonjë marke të regjistruar nga ky i fundit në cilësinë e prodhuesit.

Përsa më sipër KVO vlerëson se ambalazhet e paraqitura dhe mostrat përkatse janë të papranueshme pasi nuk vëretojnë origjinalitetin e mallrave të kërkuara dhe vijjnë në kundërshtim me deklarimet e ofertuesit se është prodhues i tyre.

- IV. Operatori Ekonomik nuk plotëson pikën 1 të Seksionit 2.3 "Kapaciteti Teknik" të Kërkesave të Vecanta për Kualifikim në lidhje me furnizimet e ngjashme janë realizuar, pasi nuk plotëson vlerën e kërkuar për furnizimet e realizuara në masën 39% e Fondit Limit ose 15,581,000 lekë pa TVSH për furnizime me detegjentë. Konkretisht referuar faturave të ngjashme të paraqitura ANBIM sh.p.k vërteton se ka realizuar furnizime për lloje të ndryshme detergjentësh dhe lëndë kimike larëse(*janë llogaritur të gjitha zërat për detergjentë të ndryshëm, klor ace, sapun të lëngshëm/ të ngurtë, si dhe cdo lloj solucioni larës*), në vlerën 13,862,000 (trembëdhjetë milion e tetëqind e gjashtëdhjetë e dy mijë) lekë pa TVSH, vlerë e cila është më e vogël se vlera e kërkuar në Kërkesat e Vecanta për Kualifikim

2. "BESIM KAMBERI" PF **S'kualifikohet**

- I. Operatori Ekonomik nuk plotëson pikën 5 të Seksionit 2.3 "Kapaciteti Teknik" të Kërkesave të Vecanta për Kualifikim, ku është kërkuar: "*Operatori ekonomik për produktet objekt prokurimi ditën e hapjes së ofertave duhet të paraqes mostrat të cilat duhet të jenë në përputhje me specifikimet teknike në DST, si dhe skeden teknike të prodhuesit në gjuhën shqipe (e përkthyer e noterizuar nëse është në gjuhë huaj*", pasi BESIM KAMBERI sh.p.k, nuk ka paraqitur skedat teknike të produkteve të ofruara respektivisht" sapun, "xhel enesh" dhe pluhur larës. KVO arsyeton se mungesa e Skedave Teknike të kërkuara përbën mospërmbyllje të një kërkesë thelbësore teknike për kualifikim pasi nuk përmbajnë asnjë nga të dhënat e detyrueshme të RREZIQEVE TË PRODUKTEVE ku përfshihen të dhënat për PARALAJMËRIMET E RREZIKUT dhe REKOMANDIMET E SIGURISË.
- II. Operatori Ekonomik nuk plotëson pikën 1 të Seksionit 2.3 "Kapaciteti Teknik" të Kërkesave të Vecanta për Kualifikim në lidhje me furnizimet e ngjashme janë realizuar, pasi nuk plotëson vlerën e kërkuar për furnizimet e realizuara në masën 39% e Fondit Limit ose 15,581,000 lekë furnizime me detegjentë. Konkretisht referuar faturave të ngjashme të paraqitura BESIM KAMBERI person fizik, vërteton se ka realizuar furnizime për lloje të ndryshme detergjentësh dhe lëndë kimike larëse(*janë llogaritur të gjitha zërat për detergjente të ndryshëm, klor ace, sapun të lëngshëm/ të ngurtë, si dhe cdo lloj solucioni larës*), në vlerën 7,500,000 (shtatë milion e pesëqind mijë) lekë pa TVSH vlerë e cila është më e vogël se vlera e kërkuar në Kërkesat e Vecanta për Kualifikim.
- III. Operatori Ekonomik nuk plotëson pikën 7 të Seksionit 2.3 "Kapaciteti Teknik" të Kërkesave të Vecanta për Kualifikim, pasi nuk vërteton me dokumente se operatorët e deklaruar si furnizues të ofertuesit perkatesisht 1. Ndricim Hysaj Person Fizik dhe 2. Gazment Zeneli Person fizik, janë distributorë të autorizuar. Konkretisht për këtë pike Ofertuesi ka paraqitur një kontratë furnizimi me "Ndricim Hysaj" Person Fizik, ku ky i

fundit deklarohet se është subjekti i autorizuar nga prodhuesi “Ergyn Kimia” Turqi për produktin “sapun”. Për këtë deklaram subjekti oferteues nuk ka paraqitur asnjë dokument ku të vërtetojë se “Ndricim Hysaj” Person Fizik është distributori i autorizuar i subjektit “Ergyn Kimia” Turqi/. Gjithashtu ofertuesi ka paraqitur një kontratë furnizimi me “Gazmend Zeneli” Person Fizik ku ky i fundit deklarohet si subjekt i autorizuar nga prodhuesi ABC Derjan Sanyi-Ve Ticaret Turqi për produktet “pluhur larës” dhe “solucion larës enësh”. Për këtë deklaram subjekti oferteues nuk ka paraqitur asnjë dokument ku të vërtetojë se “Gazmend Zeneli” Person Fizik është distributori i autorizuar për shtije të produktit “sapun” nga ABC Derjan Sanyi-Ve Ticaret Turqi. Për sa më sipër ofertuesi BESIM KAMBERI person fizik nuk vërteton kërkesat për kualifikim sipas pikës 7 të Seksionit 2.3 ”Kapaciteti Teknik, në lidhje me vërtetimin e origjinës së furnizimit dhe të drejtat tregtare për tregtimin e produkteve objekt i këtij prokurimi.

3. “EUROMEGA 2010 ” sh.p.k

S’kualifikohet

- I. Operatori Ekonomik nuk plotëson kërkesën në DST për numrin e ofertave të lejuara në procën e prokurimit nga një ofertues pasi rezulton se ky ofertues paraqiti dy oferta ekonomike. Konkretisht EUROMEGA 2010, ka ngarkuar në SPE dy oferta ekonomike në vlerat:
Oferta 1: 33,650,000 (tridhjetë e tre milion e gjashtëqind e pesëdhjetë mijë) lekë pa TVSH (*me numra dhe fjalë*) Oferta 2.: 27,320,000 (njzetë e shtatë milion milion e treqind e njëzetë mijë) lekë pa TVSH (*me numra dhe fjalë*). Referuar DST Seksioni i Përgjithshëm në këtë procedurë nuk lejohet më shumë se 1 ofertë ose ofertë alternative. Në zbatim të nenit pikës 4 të nenit 79 të VKM nr.285 dt.19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” **operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vetëm një ofertë, me përjashtim të rasteve kur kërkohen oferta alternative** dhe për këtë arsye subjekti EUROMEGA 2010 s’kualifikohet nga renditja në këtë procedurë dhe ofertat refuzohen.

4. “ATLANTIK ” sh.p.k

S’kualifikohet

- I. Operatori Ekonomik nuk plotëson kërkesat në DST për dorëzimin e ofertave pasi nuk paraqiti ofertë ekonomike.
- II. Operatori Ekonomik nuk plotëson pikën 5 të Seksionit 2.3 ”Kapaciteti Teknik” të Kërkesave të Veçanta për Kualifikim, pasi nuk paraqiti mostrat e produkteve në ditën e hapjes të ofertave.

5. “GET KLIN” sh.p.k

S’kualifikohet

- I. Operatori Ekonomik nuk ka paraqitur dokumente për kualifikim si dhe nuk ka ofertë ekonomike.

6. “MURATI-D” sh.p.k

S’kualifikohet

- I. Operatori Ekonomik nuk plotëson pikën 5 të Seksionit 2.3 ”Kapaciteti Teknik” të Kërkesave të Vecanta për Kualifikim, ku është kërkuar: “*Operatori ekonomik për produktet objekt prokurimi ditën e hapjes së ofertave duhet të paraqes mostrat të cilat duhet të jenë në përputhje me specifikimet teknike në DST, si dhe skeden teknike të prodhuesit në gjuhën shqipe (e përkthyer e noterizuar nëse është në gjuhë huaj*”, pasi MURATI-D sh.p.k nuk ka paraqitur skedat teknike të produkteve të ofruara respektivisht” sapun, “xhel enesh” dhe pluhur larës.
- II. Operatori Ekonomik nuk plotëson pikën 1 të Seksionit 2.1 ”Kapaciteti Financiar dhe Ekonomik” të Kërkesave të Vecanta për Kualifikim, pasi nuk paraqiti dokumentin mbi xhiron vjetore.
- III. Operatori Ekonomik nuk plotëson pikën 5 të Seksionit 2.3 ”Kapaciteti Teknik” të Kërkesave të Vecanta për Kualifikim, ku është kërkuar: “*Operatori ekonomik për produktet objekt prokurimi ditën e hapjes së ofertave duhet të paraqes mostrat të cilat duhet të jenë në përputhje me specifikimet teknike në DST, si dhe skeden teknike të prodhuesit në gjuhën shqipe (e përkthyer e noterizuar nëse është në gjuhë huaj*”. Për këtë kërkesë mostra e paraqitur në lidhje me produktin “xhel enesh” pasi ajo paraqitet në ambalazhin 200 gram/copë ndërkohë që në specifikimet teknikeshtojac 5 e DST kërkohet detyrimisht jo më pak se 400 gram për copë.

Duke iu referuar procedurës së mësipërme, ju informojmë se operatorët ekonomikë të mëposhtëm janë identifikuar si të suksesshëm:

2) “MALVINA VISOKA” PF

L61608005C

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Vlera: **33,750,000** (tridhjetë e tre milion e shtatëqind e pesëdhjetë mijë) **lekë pa TVSH**

3) “AN & RA” SH.P.K

K12205001I

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Vlera: **33,808,000** (tridhjetë e tre milion e tetëqind e tetë mijë) **lekë pa TVSH**

Njoftimi i Vlerësimit është bërë në datë **04.04.2024**

Ankesa për dokumentat e tenderit: **JO**

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 109 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”.

* * *

**TITULLARI I ORGANIT QENDROR BLERËS
DREJTOR I PËRGJITHSHËM**